

**STATUTI
I SHOQERISE PRIVATE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“WAN CONSTRUCTION” SHPK**



Aplikantja: Jona Wga


STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“WAN CONSTRUCTION” SHPK

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “WAN CONSTRUCTION” Sh.p.k, që këtu e më poshtë do të quhet “Shoqëria”, zotërohet nga ortaku:

1- ALI NAGI ALI LAWWAN atesia **ALI**, shtetas **LIBAN**, lindur me 01.01.1949 ne **SABHA**, identifikohet nepermjet pasaportes **GJGG1Y8J**.

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë Statut të shoqërisë “WAN CONSTRUCTION” Sh.p.k. mbi bazen e ketyre principeve:

KAPITULLI
EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE,
SELIA, TERRITORI

NENI 1
FORMA DHE EMRI

1.1 Shoqëria ka formën e shoqërise me përgjegjësi të kufizuar, me initiale Sh.P.K., të cilat vijnë përpara ose menjëhere pas emrit të shoqërise. Kjo shoqëri i përballon humbjet deri në kufirin maksimal të vlerës së kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërise.

1.2 Emri i shoqërise është “WAN CONSTRUCTION” Shpk

1.3 Forma dhe emri i shoqërise mund të ndryshohen me vendim të Asamblese së Pergjithshme të Ortakeve.

NENI 2
BAZA LIGJORE

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 dhe Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, në përputhje me legjislacionin shqiptarë në përgjithsi, në përputhje me aktet e shoqërise si dhe në përputhje me marreveshjet ndërkombetare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërise.



NENI 3
SELIA

Aplikantja
Jona Wga


Selia e shoqërise është në adresën: Rruga "DESHMORET" Lagja nr.4, Godina me xhama afër karburant ALPET, Kati i 2, Zyra 22, Nr. Pronësie 6/62, zona kadastrale 8514, Durrës, Shqipëri.

Në adresën e mesipërme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim të asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose përfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë sipas fushave në të cilat e ushtron veprimtarinë shoqëria.

NENI 4 TERRITORI

4.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj lirisht si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

4.2 Shoqëria mund të krijojë zyra ose përfaqësi të saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Zyrat, filialet ose përfaqësitë e shoqërisë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

KAPITULLI II OBJEKTI DHE KOHEZGJATJA E SHOQËRISË

NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria "WAN CONSTRUCTION" Sh.p.k. është e organizuar në formën e një shoqërie e cila ka si objektiv punime në fushën e ndërtimit.


NENI 6 KOHEZGJATJA

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat të papërcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedurë likuidimi me vendim të Asamblese së Ortakëve, si dhe në rastet e tjera të parashikuara në ligj.

KAPITULLI III KONFIDENCIALITETI, DOKUMENTET E DISTINUARA PËR TË TRETET

NENI 7 KONFIDENCIALITETI

Ortakët e shoqërisë si dhe personat e tjerë të pranuar në shoqëri, bien dakord që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, çdo lloj materiali, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për

Aplikantja: Jona Wiza  3



të ardhmen e saj.

NENI 8

DOKUMENTET E DESTINUARA PER TE TRETET

Të gjithë aktet dhe dokumentet që nxirren nga shoqëria dhe të destinuara për të tretët, si letrat, faturat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme etj., duhet të tregojnë lexueshem emrin e shoqërise dhe pas tij fjalet “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose inicialet “Sh.P.K.”, si dhe emrin e administratorit ose te administratorëve.

KAPITULLI IV

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET DHE TRASFERIMI I TYRE

NENI 9

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 LEKE (Njëqind mijë Leke), i ndare në 1 pjese. Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

1. ALI NAGI ALI LAWWAN	100,00%	100.000,00 LEKE
-------------------------------	----------------	------------------------

Kapitali themeltar i shoqërise është shlyer tërësisht dhe depozituar ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

NENI 10

TE DREJTAT E ORTAKEVE NE LIDHJE ME KAPITALIN

10.1 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërise kryhet sipas vendimit të asamblese së përgjithshme të ortakeve, me shumicën e $\frac{3}{4}$ (tre të katërtave) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërise.

10.2 Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar, i perket ortakeve e drejta me opcion mbi kapitalin ne zmadhim, ne proporcion me kuoten e kapitalit qe kane ne pronesi. Nese ndonjeri nga ortaket nuk do te nenshkruaj kuoten e tij te kapitalit ne zmadhim, e drejta e opcionit do ti perkase ortakeve te tjere. Duke mos e ushtruar ortakët të drejtën e opcionit, kapitali në zmadhim i panëshkruar do te nënshkruhet nga palë të treta.

10.3 Përgjegjësia e ortakëve për detyrimet e shoqërise shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e saj themeltar.

10.4 Kuotat e kapitalit të shoqërise nuk mund të rendohen lirisht me barrë siguroese



Aplikantja: Jona Wga 

apo të drejta të tjera reale. Në rast shitje të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërise për efekt zbatimi të një vendimi gjyqësor apo përmbushje të një detyrimi, enti që ekzekuton vendimin ose detyrimin (zyra përmbartimore ose ndonjë organ tjetër kompetent), duhet të ketë në konsiderate respektimin e kërkesave të nenit 13 të këtij statuti. Secili ortak që rëndon me barrë apo të drejta të tjera reale kuotat e tij, ka detyrimin të shpjegojë neni 13 të këtij statuti subjektit në favor të cilit vendoset barra siguruese.

10.5 Secili ortak ushtron të drejtat pasurore të parashikuara nga ligji në proporcion me kuotat e pjesemarrjes në kapital.

10.6 Ortakët që nuk marrin pjesë në administrimin e shoqërise kanë të drejtë t'i kërkojnë organit administrativ informacione mbi aktivitetin e shoqërise, si dhe të konsultojnë dokumentet kontabel e dokumentet e tjera që lidhen me administrimin e saj.

NENI 11

FUSHA E AUTORITETIT TE ORTAKUT

Fusha e autoritetit të ortakëve, përçindja e fitimeve ose humbjeve do të kene si kriter bazë kontributin e çdo ortaku në kapitalin e shoqërise, si dhe kompetencat që gezon ortaku në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuar në këtë statut.

NENI 12

FINANCIMI I SHOQERISE

12.1 Organi administrativ, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ka të drejtë të kërkojë nga ortakët fondet e nevojshme për arritjen e objektit të shoqërise.

12.2 Financimet e mëtejshme të ortakëve do të jene me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit jepen këto fonde.

NENI 13

TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT

13.1 Kapitali themeltar i shoqërise ose pjesë të tij mund të trasferohen lirisht mes ortakeve të shoqërise. Kapitali themeltar i shoqërise ose pjesë të tij mund të trasferohen tek persona të tretë vetëm pasi ortakët e shoqërise në përputhje me dispozitat e legjisllacionit shqiptar zyrtarisht kanë refuzuar ushtrimin e të drejtes së parablerjes.

13.2 Trasferimi i kapitalit themeltar të shoqërise ose i pjeseve te tij tek persona të tretë behet vetëm në këtë mënyre:

- Oferta për shitje u drejtohet të gjithë ortakeve me shkrim;
- Oferta duhet të percaktojë numrin e kuotave që shiten dhe çmimin e tyre;

Nese ortakët e shoqërise brenda 3 (tre) muaj nga oferta me shkrim nuk pranojnë blerjen e kuotave të ofruara me çmimin e përcaktuar, atehere konsiderohet se ata lejojnë shitblerjen tek të tretet.

Aplikantja
Jona Wjga

13.3 Kapitali themeltar eshte lirisht i trashgueshem ne rruge trashigimie. Bashkshorti, paraardhesit dhe pasardhesit mund te behen ortake nepermjet transferimit te pjeseve te kapitalit themeltar sipas kushteve qe lejohen ne ligj.

13.4 Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohen me akt noterial dhe te depozitohen ne organin kompetent.

13.5 Klauzolë miratimi. Nëse asnjë ortak nuk do të ushtrojë të drejtën e parablerjes ne kohe dhe sipas kushteve të parashikuar për transferimin e kuotave apo të drejtën e opcionit, kalimi i kuotave nuk do të mund të bëhet pa pëlqimin e Asamblese se Ortakeve që vendos për pranimin e transferimit te nje person i tretë. Ortaket mblidhen jo më herët se 30 (tridhjetë) ditë, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) dite, nëpermjet Asamblese të Zakonshme të Ortakeve, duke vendosur me votën pro (ne favor) me të paktën gjysmen e kapitalit themeltar.

13.6 Pelqimi mund te refuzohet vetem kur bleresi nuk jep garanci te mjaftueshme rreth kapaciteteve financiare ose për kushtet objektive o për aktivitetin që kryen, të tilla që hyrja e tij në shoqëri mund të jenë e dëmshme për arritjen e objektivave nga shoqëria ose konflikt me interesat e shoqërisë apo te ortakevete te tjerë. Asambleja e Ortakeve duhet të njoftojë me shkrim në adresën që rezulton vendimin për miratim.

Nëse brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës për miratim ortaku kërkues qe nuk ka marrë asnjë komunikim miratimi do të konsiderohet si i dhene dhe ortaket mund të transferojne kuoten e tyre.

13.7 Nëse miratimi i mohohet do të prezantohet një tjetër blerës. Për këtë qëllim, Asambleja e Ortakeve duhet të tregojë në letrën e refuzimit emrin e blerësit të propozuar; transferimi duhet të plotësohet me të njëjtat kushte të përcaktuara në kërkesën për miratim nga ana e aplikantit brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve pas marrjes së komunikimit të fundit.

Përndryshe, ortaku do të jetë i lire për të shitur pjesëmarrjen e tij personit që konsideron me te përshtatshem.

KAPITULLI V

ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE


NENI 14

ORGANET DREJTUESE

14.1 Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë Asambleja e Ortakëve dhe Administratori. Për efekt të ndryshimeve që mund të pësoje shoqëria në të ardhmen dhe shtimit të numrit të ortakëve, këtu e në vazhdim organit zotërues të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë do ti referohemi me termin Asamble e Ortakëve.



Aplikantja
Jana Waga



14.2 Shoqëria mund të emerojë më shumë se një Administrator. Në çdo rast, kur termi "Administrator" përdoret për të përcaktuar Administratorin e shoqërisë "WAN CONSTRUCTION" Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë Administratorët e saj sado qofshin këta në numër.

14.3 Përveç organeve të parashikuara më sipër Asambleja e Ortakeve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre.

14.4 Administratorët e shoqërisë për një periudhë 5 (pese) vjeçare janë emëruar :

1. ALI NAGI ALI LAWWAN

2. JONA LUGA

Te cilet mund ti ushtrojne kompetencat e tyre bashkarisht, ose vec e vec.

KAPITULLI VI ASAMBLEJA E ORTAKEVE

NENI 15

VENDIMET E ASAMBLESE TE ORTAKEVE

15.1 Asambleja e Ortakeve vendos për çështjet që ligji apo ky statut i rezervon këtij organi, si dhe për çështjet për të cilat, organi administrativ kërkon mendimin apo miratimin e ortakeve.

15.2 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortaket me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 50 % të kuotave të kapitalit themeltar.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas ligjit mbi shoqëritë tregtare, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortaket që zoterojnë më shumë se 75 % të numrit total të kuotave të kapitalit themeltar janë të pranishëm dhe vendosin me votën e $\frac{3}{4}$ (tre të katertave).


NENI 16

KONSULTIMI ME SHKRIM I ORTAKEVE

16.1 Në përputhje me dispozitat e statutit, vendimet e ortakeve mund të merren pas një konsultimi me shkrim që organi administrativ i drejton secilit prej tyre. Në këtë rast, organi administrativ i komunikon ortakeve tekstin e projekt-vendimit që do të merret dhe i kërkon të shprehin vullnetin e tyre në lidhje me këtë çështje.

16.2 Vendimet e marra në këtë mënyrë janë të vlefshme kur vendimi merret nga shumica që ligji apo ky statut kërkon për atë çështje.



Aplilantja Jona Luga 

NENI 17
MENYRA DHE VENDI I THIRRJES
I ASAMBLESE SE ORTAKEVE

17.1 Asambeja e Ortakeve thirret prane selise se shoqerise, apo ne ndonje vend tjeter brenda Republikes se Shqiperise, nepermjet nje njoftimi me shkrim edhe nepermjet postes elektronike (E-mail), duke e konfirmuar marrjen, qe iu dergohet ortakeve nga Kryetari i Asamblese se Ortakeve dhe / ose Organi Administrativ.

17.2 Njoftimi i thirrjes se mbledhjes se asamblese duhet te kryhet 15 (pesembedhjete) dite perpara dates se mbledhjes dhe duhet te percaktoje shprehimisht daten, oren, vendin si dhe rendin e dites. Ne rast pamundesie apo mosveprimi nga ana e organit administrativ, mbledhja e asamblese se ortakeve mund te thirret nga esporti kontabel i autorizuar, nese ka te tille, ose nga nje apo me shume ortake, te cilet perfaqesojne jo me pak se 10% te kapitalit te shoqerise.

NENI 18
KRYETARI I ASAMBLESE SE ORTAKEVE

18.1 Mbledhja e Asamblese se Ortakeve emerone Kryetarin e Asamblese.

18.2 Kryetari i Asamblese verifikon thirrjen dhe mbledhjen e rregullt te Asamblese se Ortakeve, verteton identitetin apo legjitimimin e perfaqesuesit te ortakeve dhe drejton zhvillimin e rregullt te mbledhjes.



Aplikantja
Jona Wpa

NENI 19
PJESEMARRJA NE VENDIME

Çdo ortak ka te drejten e nje vote per çdo kuote te kapitalit themeltar te shoqerise qe ai zoteron. Nje ortak mund te perfaqesohet ne mbledhjen e asamblese nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete, nepermjet nje akti perfaqesimi me shkrim.

NENI 20
KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

20.1 Asambleja e Ortakeve mund te jete e zakonshme dhe e jashtezakonshme, kjo ne varesi te çeshtjes per te cilen eshte thirrur. Vendimet e Asamblese se Zakonshme te Ortakeve merren me shumice te thjeshte te votave te ortakeve. Vendimet e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve merren me nje shumice te cilesuar prej $\frac{3}{4}$ (tre te katertave) te votave te ortakeve te shoqerise. Per çfare nuk eshte pasqyruar ne kete nene, Asambleja e Ortakeve te shoqerise vendos ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14. 04. 2008.


20.2 Kompetencat e Asamblese se Zakonshme te Ortakeve do te jene:

- Vendos per perpilimin ose miratimin e rregulloreve per shoqerine apo per fusha te veçanta te veprimtarise.
- Vendos per ndryshimin e selise se shoqerise.
- Vendos per krijimin e zyrave ose te perfaqesive si dhe per krijimin e shoqerive ose te ortakerive me persona te tjere fizike apo juridike.
- Vendos per politiken afariste te shoqerise dhe percakton fushat konkrete te veprimtarise se saj.
- Emeron dhe shkarkon Administratorin e shoqerise, ekspertin kontabel, likujdatori duke percaktuar dhe detajuar kompetencat e tyre, te drejttat, detyrimet, kohezgjatjen ne detyre, dhe shperblimin e tyre.
- Vendos ne lidhje me krijimin e organeve te tjera drejtuese qe mund t'i nevojiten shoqerise duke percaktuar ne aktet e krijimit te ketyre organeve, kohezgjatjen dhe kompetencat e tyre, per emerimin e personave drejtues te ketyre organeve.
- Asambleja e Ortakeve marrjen e vendimeve e kryen vete dhe nuk ben delegimin e vendimarrjes te asnje organ tjeter. Asambleja e Ortakeve vendos edhe ne lidhje me krijimin e sektoreve te veçante te veprimtarise se shoqerise.
- Shqyrton dhe miraton bilancin vjetor.
- Miraton tarifat e sherbimeve te shoqerise.
- Miraton pagat e te punesuarve ne shoqeri.

20.3 Kompetencat e Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve jane:

- Vendos ne lidhje me zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise.
- Vendos ne lidhje me kohezgjatjen e shoqerise si dhe per mbarimin e likujdimin e saj.
- Vendos per ndryshimin e emrit te shoqerise.



Aplikantja
Jana Wga 

- Vendos ne lidhje me ndryshimin e statutit te shoqerise.
- Vendos per ndryshimin e formes, per ndarjen e shoqerise si dhe per bashkimin e saj me shoqeri te tjera.
- Percakton llojin e fondeve te ndryshme dhe masen e tyre, percaktimin e dividendit, marrjen dhe dhenien e huave, kredive, borxheve.
- Realizon marredheniet me te rendesishme ekonomike dhe financiare te shoqerise me persona te tjere fizik apo juridik, vendas apo te huaj.
- Vendos ne lidhje me transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise.

20.4 Pervec kompetencave te lartpermendura, te cilat jane ekskluzive per te, Asambleja e Ortakeve ushtron çdo kompetence qe ia njeh ligji.

NENI 21


ADMINISTRATORI DHE KOMPETENCAT E TIJ

21.1 Kompetencat e Administratorit ose te Administratoreve, te cilet mund edhe te mos jene ortake te shoqerise, ne menyre konkrete dhe te detajuar percaktohen ne aktin e tyre te emerimit. Vec te tjerave qe mund te detajohen ne kete akt, Administratori ka edhe keto kompetenca:

- Kujdeset per funksionimin e perditshem normal te shoqerise ose te nje pjese te aktivitetit ekonomik dhe financiar te saj, sipas percaktimit ne aktin e emerimit.
- Pergatit dokumentacionin dhe raportet e ndryshme per gjendjen ekonomike dhe financiare te shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ia paraqet Asamblese se Ortakeve per shqyrtim.
- Koordinon veprimtarine e personave te punesuar ne shoqeri.
- Ndjek problemet e shoqerise ne marredhenie me organet shteterore ose cakton ndonje prej personelit per trajtimin e ketyre problemeve.
- I propozon Asamblese se Ortakeve tarifat e sherbimeve dhe pagat per personelin e punesuar ne shoqeri.
- I propozon Asamblese se Ortakeve rregulloren e shoqerise.
- Administratoret kane te drejte te gjitha sebashku ose vecmas nga njeri tjetri te perfaqesojne shoqerine ne lidhje me te tretet.

21.2 Administratori ose Administratoret jane pergjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve qofte per shkelje ligjore, qofte per shkelje te statutit ose per faje te kryera gjate ushtrimit te administrimit te shoqerise. Pergjegjesia eshte individuale ose solidare, kjo ne varesi te rrethanave dhe te menyres se si eshte vepruar, pra individualisht ose solidarisht.



Aplikantja
Jana Wpa 

21.3 Administratori o Administratorët nuk janë përgjegjës ndaj shoqërisë ose të tregëtuesve për konfliktin e interesit që mund të krijohet duke zhvilluar pozicione të ndryshme ose të ngjashme në shoqëri dhe organizma të ndryshëm.

KAPITULLI VII **KONTROLLI KONTABEL,** **BILANCI, DIVIDENTET**

NENI 22 **KONTROLLI KONTABEL**

Kontrolli i jashtëm kontabel i shoqërisë kryhet nga ekspertë kontabel të autorizuar, sipas legjisllacionit në fuqi. Asambleja e Ortakëve do të emerojë një apo më shumë ekspertë kontabel në ato raste kur emerimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

NENI 23 **BILANCI DHE REZERVAT**


23.1 Bilanci mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti. Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel i autorizuar, i paraqiten për shqyrtim asamblese së ortakëve, e cila vendos mbi miratimin, ndryshimin ose rrezimin e këtyre akteve, kur e konsideron të nevojshme Asambleja e Ortakëve mund të bëjë rekomandimet e nevojshme në lidhje me çështjen në diskutim.

23.2 Me mbylljen e secilit vit financiar, Administratori i vetëm merr masat e nevojshme për hartimin e projekt-bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur, në mënyrë që Asambleja e Ortakëve të vendosë mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme të tij brenda afatëve të përcaktuara nga ligji.

23.3 Asambleja e Ortakëve vendos mbi ndarjen ndërmjet ortakëve të shumave që rezultojnë si fitime sipas bilancit të aprovuar rregullisht, pasi nga këto shuma të jenë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme, si dhe të jenë lënë menjpënjëshi shumat e nevojshme për krijimin e rezervës ligjore. Rezerva ligjore krijohet vit pas viti nëpërmjet lenies menjpënjëshi të një shume të barabartë me 5 % të fitimit neto të realizuar gjatë secilit vit financiar, deri sa të arrihet një shume e barabartë me 10 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

23.4 Asambleja e Ortakëve në çdo moment mund të vendosë krijimin e rezervave të tjera, si dhe masën e tyre.

KAPITULLI VIII **MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË,**

Aplikantja: *Bona Wiza*


LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE

NENI 24 MBARIMI

Shoqëria mbaron me vendim të Asamblese së Jashtëzakonshme të Ortakeve ose kur ka një prishje të parakohshme për arsyt e parashikuara në ligj.

NENI 25 LIKUJDIMI

25.1 Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi Asambleja e Ortakeve cakton një ose disa likujdues, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likujdimit dhe mbi afatin e nevojshëm të perfundimit të tyre.

25.2 Në fund të procesit të likujdimit, Asambleja e Ortakeve vendos mbi bilancin perfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit të likujdimit.

25.3 Mbas pagimit të kreditorëve Asambleja e Ortakeve mban pjesën e mbetur të kapitalit që u shperndahet ortakeve.

NENI 26 LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE


26.1 E drejta e largimit lejohet në rastet e parashikuara me ligj. Njoftimi i largimit duhet të dërgohet shoqërisë me shkrim dhe duhet të përfshijë emër mbiemër të ortakut që largohet, vendbanimin, për komunikimet e nevojshme mbi procedurën e largimit dhe numrin e kuotave në lidhje me të cilat synon të largohet motivimet përkatëse.

Ortakët që largohen nga shoqëria kanë të drejtë të marrin një rimbursim të kuotave në proporcion të kapitalit të shoqërisë. Për këtë qëllim është përcaktuar duke marrë parasysh vlerën e tij të llogaritur në bazë të kapitalit neto.

26.2 Shlyerja e kuotave për të cilën është ushtruar e drejta e largimit duhet të bëhet brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga komunikimi që i bëhet shoqërisë. Ajo gjithashtu mund të bëhet me anë të blerjes nga ortakët e tjerë në proporcion me pjesëmarrjen e tyre ose nga një palë e tretë të identifikuar në mënyrë unanime nga ortakët. Për këtë qëllim, administratorit i kërkohet që të njoftojë ortakët e tjerë mbi mbarëvajtjen e procedurës së largimit të ortakut, dhe t'ia ofrojë për shitje, në emër dhe për llogari të ortakut që largohet, pjesën mbi të cilën është ushtruar largimi, duke deklaruar çmimin e kuotes dhe afatin për pagesën e saj, jo më shumë se 3 (tre) muaj. Për shitjen zbatohen rregulla mbi ushtrimin e së drejtës të parablerjes në këtë Statut.

26.3 Ortakët duhet të informojnë shoqërinë për qëllimin e tyre për të blerë kuotat e ortakut që largohet ose emrin e palës së tretë blerëse brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga



Aplikantja: Jona Lupa


marrja e komunikimit nga shoqëria dhe qëllimin e ortakut për t'u larguar. Nëse oferta është pranuar nga shumica e ortakëve, pjesa e ortakut që largohet do të ndahet në proporcion midis ortakëve në baze të kuotave përkatëse që kanë në kapitalin themeltare.

Nëse kjo nuk ndodh, rimbursimi do të bëhet duke përdorur rezervat e disponueshme ose në mungesë përkatësisht zvogëlimin e kapitalit; nëse nuk është e mundur një rimbursim i kuotave të ortakut që largohet, atëherë shoqëria vendoset në likuidim.

26.4 Përjashtimi i ortakut mund të bëhet, në rast të vonesës apo pamundësisë së kryerjes të punës ose shërbimeve që mund të kryhen nga një ortakë.

Përjashtimi duhet të përcaktohet me vendim të Asamblese së Përgjithshme të Ortakëve me tre të katërtat e votave.

Pas zbulimit të vendimit për të përjashtuar ortakun, ky i fundit është i penguar për të ushtruar të drejtat shoqërore.

26.5 Për likuidimin e kuotës të ortakut që largohet, aplikohet procedura e rimbursimit e parashikuar për largimin, përjashtuar këtu mundësia e shlyerjes së kuotës nëpërmjet reduktimit të kapitalit themeltare dhe likuidimin e mundshëm të shoqërisë.

Përjashtimi mund të revokohet, derisa kuota e ortakut të përjashtuar nuk i është rimborsuar.

KAPITULLI IX

MOSMARREVESHJET DHE DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 27

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Çdo mosmarreveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kesaj shoqërie, ortakët do të angazhohen se do ta zgjidhin me mirekuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarreveshjeve a konflikteve të mundshme do të jete Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

NENI 28

DISPOZITA TE FUNDIT

28.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë Statut dhe me ligjin shqiptarë. Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut, do të aplikohen dispozitat e legjisllacionit shqiptarë në fushën e shoqërive tregtare si dhe legjisllacioni shqiptarë në përgjithsi.

28.2 Shoqëria do të ketë vulën, stemen, logon dhe faqen e internetit (website), format dhe madhësitë do të përcaktohen nga asambleja e ortakëve në veçanti dhe me propozim të administratorit.



Aplikantja: Jona Lypso


28.3 Ky Statut eshte hartuar ne 3 (tre) ekzemplare, duke patur secili ekzemplare fuqi te njejte ligjore.

Tirane, 23/03/2021

ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE
"WAN CONSTRUCTION" SH.P.K.

ALI NAGI ALI LAWWAN



Aplikantja
Jona Lopo
